FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 49

Tiranë – E hënë, 29 mars 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 25.3.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues".....	5223
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 29.3.2021	Për shpalljen ditë zie kombëtare në nderim të të ndjerit, Bashkim Fino, Kryeministër i Qeverisë së Pajtimit Kombëtar, deputet dhe politikan i shquar.....	5223
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 208, datë 29.3.2021	Për dhënie ndihme financiare familjes së Dëshmorit të Atdheut Arjan Sala.....	5224
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 29.3.2021	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit me qëllim konvertimi.....	5224
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 26.3.2021	Për saktësimin e procedurave për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e tjera në import të furnizimit të mallrave e shërbimeve, të lidhura me ndërtimin dhe funksionimin e spitalit deri në datën e dhurimit të tij, i cili do të ndërtohet nga Qeveria e Republikës së Turqisë në Fier, Shqipëri.....	5249
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 188, datë 23.3.2021	Për delegimin e kompetencave.....	5251
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 63, datë 1.3.2021	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, "Albgaz" sh.a.....	5251
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 64, datë 4.3.2021	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "Seman Sunpower" sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke) në favor të "Intesa Sanpaolo Bank" sh.a.....	5252

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 65, datë 4.3.2021	Mbi përfundimin e procedurave për heqjen e licencave të shoqërisë "Sang 1" sh.p.k., për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	5253
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 66, datë 4.3.2021	Mbi dhënien e autorizimit, nga ana e ERE-s, për shitjen e 79% të kuotave të shoqërisë "Sang 1" sh.p.k.....	5255

AKT NORMATIV
Nr. 12, datë 25.3.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 112/2020, "PËR REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES"

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 2, fjalët "... komunitetet fetare ..." zëvendësohen me fjalët "... bashkësitë fetare ...".

Neni 2

Në pikën 3.2.1, të nenit 4, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalët "... adresa e rezidencës së përhershme ..." zëvendësohen me "... adresa e vendbanimit ...".

2. Në shkronjën "c", pas paragrafit "data e lëshimit dhe data e skadimit e dokumentit të udhëtimit" shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"- adresa e vendbanimit.".

Neni 3

Në shkronjën "b", të pikës 3, të nenit 5, fjalët "... brenda 30 ditëve ..." zëvendësohen me "... brenda 90 ditëve ...".

Neni 4

Në pikën 1, të nenit 14, fjalët "... në pikën 5.1 ..." zëvendësohen me "... në pikën 3.1...".

Neni 5

Në nenin 15, fjalët "... jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga krijimi i regjistrit, sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij neni ..." zëvendësohen me "... brenda datës 30.6.2021 ...".

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 207, datë 29.3.2021

PËR SHPALLJEN DITË ZIE KOMBËTARE NË NDERIM TË TË NDJERIT, BASHKIM FINO, KRYEMINISTËR I QEVERISË SË PAJTIMIT KOMBËTAR, DEPUTET DHE POLITIKANI SHQUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre", dhe në vijim të pikës 12, të kapitullit VI, të ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zie kombëtare, ditën e hënë, datë 29.3.2021, në nderim të të ndjerit, Bashkim Fino, Kryeministër i Qeverisë së Pajtimit Kombëtar dhe deputet në një sërë legjislaturash.

2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmë shtize.

3. Ceremonia e homazheve të organizohet ditën e hënë, datë 29.3.2021, nga ora 12:00 deri në orën 16:00, në mjediset e Pallatit të Kongreseve.

4. Shpenzimet e varrimit dhe të ceremonialit të përballohen nga institucioni organizator i ceremonialit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 208, datë 29.3.2021

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË DËSHMORIT TË ATDHEUT ARJAN SALA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, në shumën 1 000 000 (një milion) lekë, familjes së Dëshmorit të Atdheut Arjan Sala, i cili humbi jetën gjatë ndërhyrjes për shpëtimin e jetëve të personave të rrezikuar nga zjarri i rënë në mjediset e tij të punës, në datën 24 mars 2021.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 209, datë 29.3.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT ME QËLLIM KONVERTIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit me qëllim konvertimi, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË
MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT ME QËLLIM KONVERTIMI

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Italisë, në vijim të quajtura "Palët",

me qëllim që t'u japin titullarëve të lejeve të drejtimit të lëshuara nga autoritetet kompetente të njërës prej Palëve, mundësinë e konvertimit në leje drejtimi të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës tjetër, si dhe për të përmirësuar sigurinë e transportit rrugor dhe për të lehtësuar trafikun rrugor në territoret përkatëse,

duke pasur parasysh Konventën për qarkullimin rrugor të bërë në Vjenë më 8 nëntor 1968,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët njohin në mënyrë të ndërsjellë, për qëllime konvertimi, lejet e drejtimit jo të përkohshme dhe brenda afatit të vlefshmërisë, që janë lëshuar nga Autoritetet kompetente të Palës tjetër, sipas legjislacionit të tyre të brendshëm, në favor të titullarëve të lejeve të drejtimit që marrin rezidencën në territorin e tyre.

Palët nuk i¡ njohin lejet e drejtimit të përkohshme dhe nuk mund të lëshojnë, për konvertim, leje drejtimi të përkohshme.

Neni 2

Leja e drejtimit e lëshuar nga Autoritetet e njërës prej Palëve pushon së qenuri e vlefshme për qëllime qarkullimi në territorin e Palës tjetër, pasi ka kaluar një vit nga data e marrjes, nga ana e titullarit, të rezidencës në territorin e Palës tjetër.

Neni 3

Në kuadrin e interpretimit të neneve të kësaj Marrëveshjeje, me "rezidencë" nënkuptohet sa është përcaktuar dhe rregulluar nga legjislacioni në fuqi i secilës Palë.

Neni 4

Titullari i lejes së drejtimit të lëshuar nga Autoritetet e njërës prej Palëve, i cili vendos rezidencën në territorin e Palës tjetër, mund ta konvertojë lejen e tij të drejtimit pa qenë nevoja të kryejë prova teorike dhe praktike, përveçse në situata të veçanta në të cilat është e nevojshme një provë praktike drejtimi. Konsiderohen situata të veçanta, ato që kanë të bëjnë me drejtuesit me kërkesa të veçanta që kërkojnë përshtatje të automjeteve, krahasuar me konfigurimin standard ose përdorimin e protezave.

Titullari i një leje drejtimi të lëshuar nga Autoritetet e njërës prej Palëve, mund të kërkojë konvertimin e lejes së tij të drejtimit, vetëm nëse është rezident në territorin e Palës që do të procedojë me konvertimin, prej më pak se katër vjetësh në momentin e paraqitjes së kërkesës për konvertim. Përndryshe kjo Marrëveshje nuk gjen zbatim.

Autoritetet kompetente mund të kërkojnë një certifikatë mjekësore që vërteton gjendjen psikofizike të nevojshme për kategoritë e kërkuara në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi të Palëve.

Për zbatimin e paragrafit të parë të këtij neni, titullari i lejes së drejtimit duhet të ketë arritur moshën minimale të parashikuar nga legjislacionet e brendshme përkatëse për lëshimin e kategorisë për të cilën ai kërkon konvertimin.

Kufizimet e drejtimit të automjetit dhe çdo ndëshkim i parashikuar në lidhje me datën e lëshimit të lejes së drejtimit nga dispozitat e brendshme të Palëve zbatohen duke iu referuar datës së lëshimit të lejes fillestare, për të cilën kërkohet konvertimi.

Neni 5

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen vetëm për lejet e drejtimit të lëshuara përpara marrjes së rezidencës nga titullari në territorin e Palës tjetër dhe, në rast se ato janë lëshuar me vlefshmëri të përkohshme, ato zbatohen vetëm kur janë bërë të vlefshme në mënyrë të përhershme para marrjes së rezidencës së lartpërmendur.

Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për ato leje drejtimi që nga ana e tyre janë marrë në zëvendësim të një dokumenti të lëshuar nga një shtet tjetër dhe që nuk mund të konvertohet në territorin e Palës që do të procedojë me konvertimin.

Neni 6

Në momentin e konvertimit të lejes së drejtimit, ekuivalenca midis kategorive të lejeve të drejtimit të lëshuara nga të dyja Palët përcaktohet nga Autoritetet kompetente të Palëve në bazë të Tabelave të Ekuivalencës bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje.

Titullari i lejes së drejtimit të lëshuar nga autoritetet e të dy Palëve e konverton atë nëse përputhet me një nga modelet e listuara në listën e Modeleve të lejeve të drejtimit bashkëngjitur kësaj Marrëveshje.

Tabelat e ekuivalencës, lista e Modeleve të lejeve të drejtimit, të plotësuara me imazhet e modeleve të identifikuara në to, si dhe modeli i Vërtetimit të përmendur në nenin 8, përbëjnë Shtojcat Teknike të Marrëveshjes. Në bazë të kësaj Marrëveshje, Shtojcat Teknike janë ligjërisht të detyrueshme. Ndryshe nga kjo Marrëveshje, Shtojcat mund të ndryshohen nga Palët në një formë të thjeshtuar përmes Shkëmbimeve të Notave Verbale. Ndryshimet dakordësuara, do të hyjnë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së marrjes së Notës së përgjigjes. Pala që ka marrë Notën e përgjigjes do të njoftojë Palën tjetër për marrjen dhe për datën e saktë të hyrjes në fuqi.

Autoritetet qendrore përgjegjëse për konvertimin e lejeve të drejtimit janë si më poshtë:

a) në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë – Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

b) në Republikën Italiane: Ministria e Infrastrukturës dhe Mobilitetit/ Lëvizshmërisë së Qëndrueshme – Departamenti i Transportit, Navigacionit, Çështjeve të Përgjithshme dhe Personelit;

Neni 7

Gjatë procedurave të konvertimit të lejeve të drejtimit, Autoritetet kompetente të Palëve tërheqin lejet e drejtimit që do të konvertohen dhe ua kthejnë ato Autoriteteve kompetente të Palës tjetër, përmes kanaleve diplomatike.

Për të dyja Palët, tërheqja e lejes se drejtimit që do të konvertohet bëhet vetëm pas dorëzimit të lejes së drejtimit të re, të lëshuar pas konvertimit.

Neni 8

Autoriteti kompetent që kryen konvertimin kërkon përkthimin zyrtar të lejes së drejtimit. I njëjti Autoritet mund të kërkojë informacion nga autoritetet kompetente të Palës tjetër, nëse lindin dyshime në lidhje me vlefshmërinë, vërtetësinë e lejes së drejtimit dhe të dhënat e raportuara në të. Komunikimet zhvillohen në gjuhën italiane. Për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion, autoriteti qendror kompetent përdor formularët e Vërtetimit bashkangjitur në këtë marrëveshje.

Neni 9

Autoriteti qendror kompetent i Palës që merr lejen e drejtimit të tërhequr, pas konvertimit, informon Palën tjetër nëse dokumenti paraqet parregullsi në lidhje me vlefshmërinë, vërtetësinë dhe të dhënat e paraqitura në të. Ky informacion mund të shkëmbehet përmes rrugëve diplomatike ose drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve qendrore. Komunikimet zhvillohen në gjuhën italiane.

Neni 10

Palët informojnë njëra-tjetrën në lidhje me adresat e autoriteteve qendrore kompetente për zbatim, sipas të neneve 7, 8 dhe 9.

Secila Palë komunikon adresat e Përfaqësive të saj diplomatike të pranishme në territorin e Palës tjetër, në zbatim të neneve 7 dhe 9.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin italian dhe shqiptar, si dhe me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme dhe, përsa i përket Palës italiane, me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i Italisë në Bashkimin Evropian.

Neni 12

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve në rrugë diplomatike.

Neni 13

Kjo Marrëveshje, me Shtojcat Teknike përkatëse, do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet me të cilat Palët do të kenë komunikuar përmbushjen e procedurave të parashikuara nga legjilacionet përkatëse për hyrjen e saj në fuqi.

Marrëveshja mund të ndryshohet me shkrim me pëlqim të ndërsjellë dhe ndryshimet do të hyjnë në fuqi sipas të njëjtës procedurë të parashikuar për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Ndryshimet në Shtojcat Teknike do të hyjnë në fuqi në një formë të thjeshtuar në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 6.

Marrëveshja do të ketë një kohëzgjatje prej pesë vjetësh. Duke filluar një vit para përfundimit të afatit, Palët do të fillojnë konsultimet për të vijuar me rinovimin e kësaj Marrëveshjeje, në mënyrë që të mos ndodhë ndërprerja, qoftë edhe e përkohshme, e konvertimit të lejeve të drejtimit. Shkëmbimi i Notave për të zgjatur vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës së marrjes së Notës së përgjigjes. Në mënyrë që të lejojë të dy Palët të përcaktojnë datën e saktë të hyrjes në fuqi të çdo Shkëmbimi të Notave, Pala që ka

marrë Notën e përgjigjes do të njoftojë Palën tjetër përmes kanaleve diplomatike për datën e marrjes dhe datën e saktë e hyrjes në fuqi.

Marrëveshja mund të denoncohet me shkrim në çdo kohë nga njëra prej Palëve dhe do të pushojë së prodhuari efektet e saj gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit.

Në mirëbesim për sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht, kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Tiranë, më 17 mars 2021, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe italiane, të gjitha tekstet janë njësoj autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË ITALISË

MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT

Modele të Lejeve të Drejtimit të lëshuara në Shqipëri renditur nga më i vjetri deri tek më i fundit.

1) Modeli i lejeve të drejtimit, lëshuar në Shqipëri nga data 01.07.2005 deri më 23.01.2017, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit n.17 datë 07.01.2003. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). Ky model është i vlefshëm deri më 23.01.2027

2) Modeli i lejeve të drejtimit, lëshuar në Shqipëri nga data 24.01.2017 në bazë të Udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës n.241/3 date 19.02.2016. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Modelet e Lejeve të Drejtimit të lëshuara në Itali të renditura nga më i vjetri deri tek më fundit.

1) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/MEC . Autoriteti përgjegjës për lëshimin:- Prefekti. Lëshuar nga viti 1959 deri në 1989

2) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/N. Autoriteti përgjegjës për lëshimin:- Prefekti. Lëshuar nga viti 1989 deri 1990

3) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/C. Autoriteti përgjegjës për lëshimin - Prefekti. Lëshuar nga viti1990 deri 1995

4) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/D. Autoriteti përgjegjës për leëhimin: - Prefekti. Lëshuar në 1995

5) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/E. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. (Motorrizimi Civil dhe Transporti me Koncesion). Lëshuar në vitin 1996

6) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/F lëshuar nga data 1 Korrik 1996 sipas Udhëzimit nr. 91/439 CEE. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. Lëshuar nga viti 1996 deri në 1997

7) modeli i Lejes së Drejtimit MC 701/ F. Numërtimi i të dhënave në faqen 2 krahasuar me modelin e pikës 6, është ndryshuar.
Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. Lëshuar nga viti1997 deri në 1999

8) modeli i Lejes se Drejtimit MC 720 F sipas Udhëzimit nr. 96/47.
Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. Ky model mund të jetë në dy gjuhë (italisht- gjermanisht) vetëm nëse Leja e Drejtimit është lëshuar në Bolzano. Lëshuar nga viti1999 deri në 2004

9) modeli i Lejes se Drejtimit MC 720 F sipas Udhëzimit nr. 96/47. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C. Ndryshon nga e mëparshmja sepse formulimi *"patente di guida" ("Leje Drejtimi)* në sfond është shkruar dhe në 10 gjuhët e shteteve që hynë në Bashkimin Evropian më 1 Maj 2004. Lëshuar nga viti 2005 deri në 2007

10) modeli i Lejes së Drejtimit MC 720 F sipas Udhëzimit nr.96/47. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: M.C.T.C.
Ndryshon nga e mëparshmja e përshkruar në pikën 9) vetem sepse numri i shtypur në pjesën e poshtme të anës së djathtë, në pjesën e prapme të dokumentit, nuk është prodhuar me shtyp por gdhendur me *laser engraving* pra e deshifrueshme vetëm me prekje. Ky model mund të jetë në dy gjuhë (italisht- gjermanisht) vetëm nëse leja e drejtimit është e lëshuar në Bolzano. Lëshuar nga viti 2007 deri në 2013

11) modeli i Lejes së Drejtimit MC 720 P sipas Udhëzimit nr.2006/126. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: MIT (Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit) ose MC (Motorizimi Civil). Ky model mund të jetë në dy gjuhë (italisht-gjermanisht) vetëm nëse leja e drejtimit është lëshuar në Bolzano. Lëshuar nga viti 2013 deri në 2014

12) modeli i Lejes së Drejtimit MC 720 P sipas Udhëzimit nr. 2006/126. Autoriteti përgjegjës për lëshimin: MIT ose MC. Ndryshon nga i mëparshmi treguar ne piken 11 sepse formulimi *"patente di guida"* në sfond, është shkruar edhe në gjuhën kroate. Lëshuar nga qershori i vitit 2014
Ky model mund të gjendet në dy gjuhë (italisht-gjermanisht) vetëm nëse leja e drejtimit është lëshuar në Bolzano. Lëshuar deri në tetor të 2014

I TABELA E EKUIVALENCËS

Për konvertimin në dokumente italiane, të lejeve të drejtimit të lëshuara në Shqipëri deri më *23.01.2017*

SHQIPËRIA	ITALIA
A	A *
B	B *
C	C *
D	C + D *
BE	BE *
CE	CE *
DE	CE + DE *

* Për pajisjen me leje drejtimi të çdo kategorie titullari duhet të ketë mbushur moshën e kërkuar nga ligji italian (neni.4 – paragrafi 4).

II TABELA E EKUIVALENCËS

Për konvertimin në dokumente italiane, të lejeve të drejtimit të lëshuara në Shqipëri nga *24.01.2017*

SHQIPËRIA	ITALIA
AM	AM *
A1	A1 *
A2	A2 *
A	A *
B1	B1 *
B	B *
C1	C1 *
C	C *
D1	D1 *
D	D *
BE	BE *
C1E	C1E *
CE	CE *
D1E	D1E *
DE	DE *

* Për pajisjen me leje drejtimi të çdo kategorie, titullari duhet të ketë mbushur moshën e kërkuar nga ligji italian (neni.4 – paragrafi 4).

III TABELA E EKUIVALENCES

Për konvertimin në dokumente shqiptare të lejeve të drejtimit të lëshuara në Itali

ITALIA	SHQIPËRIA
AM	AM *
A1	A1 *
A2	A2 *
A	A *
B1	B1 *
B (lëshuar para datës 01.01.1986)	A+B *
B (lëshuar nga data 01.01.1986)	B *
BE	BE *
C1	C1 *
C1E	C1E *
C	C *
CE	CE *
D1	D1 *
D1E	D1E *
D (lëshuar para datës 01.10.2004)	C+D *
D (lëshuar që prej datës 01.10.2004)	D *
DE (lëshuar para datës 01.10.2004)	C+DE *
DE (lëshuar që prej datës 01.10.2004)	DE *
CE+D	CE+DE *

* Për lëshimin e çdo kategorie titullari duhet të ketë mbushur moshën e parashikuar nga ligji shqiptar (neni 4 paragrafi 4)

Modeli 1

Da: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Shqipëri
e-mail : dpshtrr@dpshtrr.gov.al

Për Zyrën e Motorizimit Civil të
_____

e-mail _____

VËRTETIM i të dhënave në lidhje me lejen e drejtimit shqiptare nr.
_____

1) TË DHËNAT PERSONALE TË TITULLARIT TË LEJEVE SË DREJTIMIT:

EMËR_____MBIEMËR_____
_____

DATA E LINDJES
_____

VENDI I LINDJES (Bashkia ose vendi)_____

_____
_____

2) **Shënime të mundshme** (për shembull: lente aparate dëgjimi.... etj… .) :

_____

3) Leja e drejtimit është e vlefshme. Skadon më _____

4) Data e marrjes së parë për secilën kategori:
_____

_____
_____

5) Leja e drejtimit nuk i nënshtrohet masave kufizuese */ u nënshtrohet masave kufizuese vijuese

_____
_____

6) Leja e drejtimit nuk rrjedh nga konvertimi i një leje drejtimi tjetër të huaj */ rrjedh nga konvertimi i një leje drejtimi tjetër të huaj në shtetin që vijon:

_____

Vendi dhe data

Drejtori

(*) shënoni rastin që nuk zbatohet

Modeli 2

Nga: *Ministria e Infrastrukturës dhe lëvizshmërisë*

së Oëndrueshme

DP e Motorizimit
Italia
e-mail: patenti.mot5@mit.gov.it

Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit
Rrugor

Albania
e-mail : dpshtrr@dpshtrr.gov.al

VËRTETIM i të dhënave në lidhje me lejen e drejtimit shqiptare nr. _____

1) TË DHËNAT PERSONALE TË TITULLARIT TË LEJEVE SË DREJTIMIT:

EMËR_____MBIEMËR_____

DATA E LINDJES _____

VENDI I LINDJES (Bashkia ose vendi)_____

_____

2) Shënime të mundshme (për shembull: lente aparate dëgjimi.... etj...) :

_____

3) Leja e drejtimit është e vlefshme. Skadon më _____

4) Data e marrjes së parë për secilën kategori: _____

_____

5) Leja e drejtimit nuk i nënshtrohet masave kufizuese */ u nënshtrohet masave kufizuese vijuese

6) Leja e drejtimit nuk rrjedh nga konvertimi i një leje drejtimi tjetër të huaj */ rrjedh nga konvertimi i një leje drejtimi tjetër të huaj në shtetin që vijon:

Vendi dhe data

Drejtori

(*) shënoni rastin që nuk zbatohet

MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT SHQIPTARE

I. Modeli i lejes së drejtimit, lëshuar nga 01.07.2005 deri më 23.01.2017 (AL 1)





II. Modeli i lejes së drejtimit, lëshuar nga data 24.01.2017 (AL I1)



Modelet e lejeve të drejtimit italiane

Modeli 1





Modeli 2


VIDIMAZIONI ANNUALI
SIMILE
CONFERMA DI VALIDITÀ
Valida fino al
Data
Firma
SOSPENSIONI DELLA PATENTE
CAMBIAMENTI DI RESIDENZA
Data
Firma
Data
Firma
FAC - SIMILE
0 0000000
REPUBBLICA ITALIANA
MINISTERO DEI TRASPORTI
I
PATENTE DI GUIDA
Modello della COMUNITÀ EUROPEA


1. Cognome
2. Nome
3. Data e luogo di nascita
4. Residenza
5. Gruppo sanguigno
Impronta del titolare
Autenticazione Uffici
Uff. Prov. di
6. Rilasc. dal Prefetto di
7. N
8. Valevole fino al
Perugia lì,
IL PREFETTO
Timbro del Prefetto
Indicazioni addizionali
Categorie di veicoli per cui la patente è valida
A
B
C
D
E

Modeli 3


SOSPENSIONI DELLA PATENTE
SIMILE
VIDIMAZIONE ANNUALE
FAC
CAMBIAMENTO DI RESIDENZA
CONFERMA DI VALIDITÀ
REPUBBLICA ITALIANA
PATENTE DI GUIDA
Modello della COMUNITÀ EUROPEA


1. Cognome
2. Nome
3. Data e luogo di nascita
4. Residenza
Via
Gruppo sanguigno
Foto del titolare
Impronta del dito
Categorie per le quali la patente è valida
A
B
C
D
E
IL PREFETTO
ANNOTAZIONI AGGIORNAMENTI

Modeli 4


SOSPENSIONI DELLA PATENTE
CAMBIAMENTI DI RESIDENZA
Data
Firma
Data
Firma
E 0000000
VIDIMAZIONI ANNUALI
CONFERMA DI VALIDITÀ
Validità fino al
Data
Firma
FAC-SIMILE
REPUBBLICA ITALIANA
I
PATENTE DI GUIDA
Permis de Conduire
Driving Licence
Permiso de Conducción
Carta de Condução
Modello della COMUNITÀ EUROPEA


1. Cognome
2. Nome
3. Data e luogo di nascita
4. Residenza
Via
Cognome sostitutivo
Firma del titolare
UMC/MC di
5. Rilasciata dal Prefetto di
6. A
7. Valevole fino al
8. Patente N.
IL PREFETTO
Categorie per le quali la patente è valida
A
B
C
D
E
INDICAZIONI ADDIZIONALI

Modeli 5

CONFERME DI VALIDITÀ
VIDIMAZIONI ANNUALI
REPUBBLICA ITALIANA
I
PATENTE DI GUIDA
CAMBIAMENTI DI RESIDENZA
FAC-SIMILE
SOSPENSIONI DELLA PATENTE
E 00000
Modello delle COMUNITÀ EUROPEE


1. Cognome
2. Nome
3. Data e luogo di nascita
4. Residenza
Via
Firma del titolare
Categorie per le quali la patente è valida
A
B
C
D
E
INDICAZIONI ADDIZIONALI
IL DIRETTORE

Modeli 6

CONFERME DI VALIDITÀ
VIDIMAZIONI ANNUALI
REPUBBLICA ITALIANA
PATENTE DI GUIDA
FAC-SIMILE
CAMBIAMENTI DI RESIDENZA
SOSPENSIONI DELLA PATENTE
Modello della COMUNITÀ EUROPEE


1. Cognome
2. Nome
3. Data e luogo di nascita
4. Residenza
Via
FIRMA DEL TITOLARE
IL DIRETTORE
INDICAZIONI ADDIZIONALI
A
B
C
D
E

Modeli 7


VIDIMAZIONI ANNUALI
CONFERME DI VALIDITÀ
CAMBIAMENTI DI RESIDENZA
SOSPENSIONI DELLA PATENTE
REPUBBLICA ITALIANA
PATENTE DI GUIDA
FAC-SIMILE


INDICAZIONI ADDIZIONALI
A
B
C
D
E

Modeli 8

PATENTE DI GUIDA
REPUBBLICA ITALIANA
1.
2.
3.
4a.
4c.
5.
7.
8.
9.
FACSIMILE


9.
10.
11.
12.
A1
A
B
C
D
CE
DE
FACSIMILE
AB 0000000

Modeli 9

PATENTE DI GUIDA
REPUBBLICA ITALIANA
1.
2.
3.
4a.
4c.
4b.
5.
7.
8.
9.
SPECIMEN


9.
10.
11.
12.
A1
A
B
C
D
BE
CE
DE
AB 0000000

Modeli 10

PATENTE DI GUIDA
REPUBBLICA ITALIANA
1.
2.
3.
4a.
4c.
4b.
5.
7.
9.
8.
FAC-SIMILE


9.
10.
11.
12.
A1
A
B
C
D
BE
CE
DE
AA 0000000

Modeli 11

PATENTE DI GUIDA REPUBBLICA ITALIANA
1.
2.
3.
4a.
4c.
4b.
5.
7.
9.
FACSIMILE


13.
9.
10.
11.
12.
AM
A1
A2
A
B1
B
C1
C
D1
D
BE
C1E
CE
D1E
DE
FACSIMILE
12.
AE 0000000

Modeli 12

PATENTE DI GUIDA REPUBBLICA ITALIANA
1.
2.
3.
4a.
4c.
4b.
5.
7.
9.
FAC SIMILE


13.
9.
10.
11.
12.
AM
A1
A2
A
B1
B
C1
C
D1
D
BE
C1E
CE
D1E
DE
12.
AE 0000000
1. Cognome 2. Nome 3. Data e luogo di nascita 4a. Data del rilascio
4b. Data di scadenza 4c. Rilasciata da 5. Numero della patente
10. Valida dal 11. Valida fino al 12. Codici
FAC SIMILE

UDHËZIM
Nr. 9, datë 26.3.2021

PËR SAKTËSIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR DHE DETYRIMET E TJERA NË IMPORT TË FURNIZIMIT TË MALLRAVE E SHËRBIMEVE, TË LIDHURA ME NDËRTIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SPITALIT DERI NË DATËN E DHURIMIT TË TIJ, I CILI DO TË NDËRTOHET NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË TURQISË NË FIER, SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 23/2021, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë", ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat që do të ndiqen për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e tjera në import të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve, sipas ligjit nr. 23/2021, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë".

Neni 2
Fusha e veprimit

Në zbatim të ligjit nr. 23/2021, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë", përjashtohet nga TVSH-ja dhe detyrimet doganore/taksat e tjera në import:

a) importimi i të gjitha llojeve të pajisjeve mjekësore, pajisjeve, orendive dhe materialeve të ndërtimit, siç sigurohen nga pala turke dhe siç tregohet në shtojcën bashkëlidhur marrëveshjes për spitalin me 150 shtretër që do të ndërtohet në Fier, Shqipëri;

b) furnizimi brenda vendit i mallrave dhe i shërbimeve për ndërtimin dhe funksionimin deri në datën e dhurimit të spitalit nga pala turke për palën shqiptare;

c) importimi i mallrave, materialeve dhe pajisjeve nga pala turke për ndërtimin dhe funksionimin e spitalit.

Neni 3
Subjektet e përjashtuara nga TVSH-ja

Subjektet e përjashtuara nga TVSH-ja, në kuadër të procesit të ndërtimit të spitalit në Fier, Shqipëri nga pala turke, janë:

a) shoqëria "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri" me numër identifikimi të personit të tatueshëm (NIPT) M12522403G, e cila është caktuar nga pala turke për kryerjen e punimeve për ndërtimin e spitalit;

b) nënkontraktorët/furnizuesit e shoqërisë "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri", të deklaruar në listën e dërguar nga kjo shoqëri pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 4
Procedura dhe mënyra e zbatimit të përjashtimit

Shoqëria "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri", për qëllim të zbatimit të këtij udhëzimi, duhet të përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dokumentacionin si më poshtë:

a) kërkesën me shkrim, së cilës i bashkëngjitet një fotokopje e certifikatës së NIPT/NUIS-it;

b) marrëveshjen e lidhur me palën turke për ndërtimin e spitalit në Fier, e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe e njësuar me origjinalin;

c) preventivin e punimeve, i cili duhet të jetë i ndarë në zëra, në sasi dhe në vlerë, ku të detajohet lista e materialeve që do të përdoren në procesin e ndërtimit;

d) listën e të gjithë nënkontraktorëve/ furnizuesve të përfshirë në procesin e ndërtimit të spitalit në Fier;

e) fotokopje të certifikatës së NIPT/NUIS-it për secilin nënkontraktor/furnizues;

f) preventivin, në të cilin duhet të jenë përcaktuar qartë mallrat dhe shërbimet e lidhura me secilin nënkontraktor/furnizues, i cili duhet të jetë i ndarë në zëra, në sasi dhe në vlerë.

Lista e nënkontraktorëve/furnizuesve mund të përditësohet nga shoqëria sa herë çmohet e nevojshme, duke informuar detyrimisht edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga shoqëria "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri".

Bazuar në rezultatet e shqyrtimit, kur përmbushen kërkesat e përcaktuara dhe është plotësuar dokumentacioni i sipërpërmendur, drejtori i përgjithshëm i Tatimeve, brenda 3 (tre) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, shprehet lidhur me aprovimin e përjashtimit sipas kërkesës.

Një kopje e aprovimit, së bashku me dokumentacionin e dërguar nga kjo shoqëri, i përcillet Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, e cila ka në administrim shoqërinë "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri". Gjithashtu, kopja e aprovimit, së bashku me dokumentacionin, i dërgohet Drejtorisë Rajonale Tatimore, që ka në administrim nënkontraktorin/furnizuesin e përcaktuar në listën e dërguar nga shoqëria "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri".

Nënkontraktorët/furnizuesit e shoqërisë "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri", të përcaktuar në listën e dërguar nga kjo shoqëri pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, janë të përjashtuar nga TVSH-ja si në blerje ashtu edhe në shitje dhe nuk aplikojnë TVSH-në për të gjitha furnizimet e mallrave apo të shërbimeve të kryera dhe të lidhura me ndërtimin apo funksionimin e spitalit në Fier, deri në datën e dhurimit të tij nga pala turke për palën shqiptare. Bazuar në dispozitat e neneve 60–70, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për të tilla furnizime të lidhura me ndërtimin apo funksionimin e spitalit të Fierit, nënkontraktorët/ furnizuesit kreditojnë tatimin e paguar në blerje.

Nënkontraktorët/furnizuesit e shoqërisë "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri", të përcaktuar në listën e dërguar nga kjo shoqëri pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilët i importojnë vetë mallrat, materialet apo pajisjet që do të përdoren prej tyre për procesin e ndërtimit të spitalit, paraqiten pranë autoritetit doganor për të përfituar përjashtimin në import për mallrat e përcaktuara në kontratën dhe preventivin e dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nga shoqëria "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri".

Drejtori i përgjithshëm i Tatimeve miraton procedurë/manual të posaçëm, me qëllim kontrollin e zbatimit të përjashtimeve, në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Neni 5
Përjashtimi në import

Mallrat, materialet dhe pajisjet e importuara nga ana e shoqërisë "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, dega Shqipëri", për ndërtimin dhe funksionimin e spitalit përjashtohen nga detyrimet doganore, taksat e tjera dhe TVSH-ja në import.

Neni 6
Përjashtime të tjera

Të gjitha furnizimet e tjera të lidhura drejtpërdrejt me ndërtimin dhe funksionimin e spitalit deri në datën e dhurimit të tij nga pala turke për palën shqiptare, janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja.

Neni 7
Plotësimi i faturës

Furnizuesit e mallrave dhe të shërbimeve të përjashtuara nga TVSH-ja sipas këtij vendimi, në momentin e lëshimit të faturës tatimore, duhet të shënojnë në faturë dispozitën ligjore, sipas së cilës furnizimi është i përjashtuar.

Neni 8
Organet zbatuese

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 188, datë 23.3.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Besfort Lamallari, nga data 25.3.2021 deri më datë 30.4.2021.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën e sipërcituar, me ndërprerje vetëm në rastet kur kompetencat rimerren nga titullari i institucionit.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, z. Besfort Lamallari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

VENDIM
Nr. 63, datë 1.3.2021

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR, "ALBGAZ" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 91, pika 2 dhe të nenit 92, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 32/1 prot., datë 26.2.2021 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, "Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, "Albgaz" sh.a.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 263, datë 28.12.2020, ka vendosur:

"- Të fillojë procedurën për miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, "Albgaz" sh.a.;".

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, janë lajmëruar palët e interesit për shprehjen e opinioneve të tyre në lidhje me fillimin e kësaj procedure, si dhe "Albgaz" sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 53 prot., datë 13.1.2021, ku i është kërkuar që të marrë në konsideratë konstatimet e vendimit të sipërcituar dhe të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës me qëllim përfundimin e procedurës.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me "Albgaz" sh.a., rezulton se nuk është përditësuar ende programi i përputhshmërisë së "Albgaz" sh.a., me konstatimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263/2020.

- Në nenin 91, pika 2, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: "Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.".

- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se:

"1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91, të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.".

- Në përmbushje të këtij afati, duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria "Albgaz" sh.a. nuk është sqaruar ende plotësisht për përditësimin e konstatimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263/2020, në programin e përputhshmërisë, e mund të jetë e nevojshme dhe organizimi i një takimi virtual për këtë qëllim, duke pasur parasysh faktin që shoqëria është në fazën e përkthimit të programit, i cili duhet dërguar dhe për opinion te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, si dhe duke pasur parasysh dhe rrethanat kufizuese të krijuara për shkak të pandemisë COVID-19, vlerësohet të zgjatet afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 30 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 30 ditë, për miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, "Albgaz" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 64, datë 4.3.2021

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË "SEMAN SUNPOWER" SHPK, PËR TRANSFERIM TË ASETEVE (VENDOSJE HIPOTEKE) NË FAVOR TË "INTESA SANPAOLO BANK" SHA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "a", nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 53, neneve 91 dhe 92, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", pikat 1.3 dhe 1.6, të "Licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 99, datë 17.6.2016; nenit 7 dhe nenit 11, pika 1, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.3.2021, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "Seman Sunpower" sh.p.k., për transferim të aseteve në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank" sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 189, datë 19.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Seman Sunpower" sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të "Intesa Sanpaolo Bank" sh.a.

- Në vijim të depozitimit për trajtimin në bord të relacionit përfundimtar nr. 33/2 prot., datë 1.3.2021, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Seman Sunpower' sh.a., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të "Intesa Sanpaolo Bank" sh.a., në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë "Seman Sunpower" sh.p.k. nr. 127/2 prot., i ERE-s, datë 2.3.2021, "Plotësim

dokumentacioni", në lidhje me kërkesën e sipërcituar.

Ajo që konstatohet paraprakisht është se shoqëria ka depozituar kontratë hipotekimi dhe listë asetesh, por duke qene se ky dokumentacion është depozituar në prag të përfundimit të afatit të vendimmarrjes së ERE-s, është e nevojshme shtyrja e vendimmarrjes finale për këtë praktikë, në mënyre që të vijohet me njohjen dhe analizimin e sa përcjellë nga shoqëria në plotësim të aplikimit të saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "Seman Sunpower" sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të "Intesa Sanpaolo Bank" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 65, datë 4.3.2021

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LICENCAVE TË SHOQËRISË "SANG" 1 SHPK, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të nenit 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 33/1 prot., datë 1.3.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 8, datë 20.1.2021, ka vendosur:

"1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Sang 1' sh.p.k., me vendimin e Bordit nr. 83, datë 31.5.2019, të ndryshuar.

2. Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave, për heqjen e licencës.

3. Shoqëria 'Sang 1' sh.p.k. duhet të shlyejë për llogari të ERE-s pagesat rregullatorë, për vitin 2020, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.".

Gjithashtu, me vendimin nr. 9, datë 20.1.2021, Bordi i ERE-s ka vendosur:

"1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Sang 1' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.6.2019.

2. Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave, për heqjen e licencës.

3. Shoqëria 'Sang 1' sh.p.k. duhet të shlyejë për llogari të ERE-s pagesën rregullatorë, për vitin 2020, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.".

- Vendimmarrja, sa më sipër, u mor në kushtet kur shoqëria nuk plotësoi në afat kushtin e vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83/2019, të ndryshuar me vendimin nr. 107/2019, për të depozituar në ERE dokumentacionin që vërteton mbështetjen financiare të shoqërisë për ndërtimin e impiantit prodhues, brenda 3 muajve

nga marrja dijeni e këtij vendimi. Po ashtu, ka rezultuar se shoqëria ka shitur 79% e kuotave, pa marrë autorizimin e ERE-s, siç përcaktohet në nenin 6.2, të "Licencës së prodhimit të energjisë elektrike", si dhe të pikës 5.2, të "Licencës së tregtimit të energjisë elektrike".

- Për vendimin nr. 8/2021 dhe nr. 9/2021, ERE ka njoftuar shoqërinë nëpërmjet shkresës nr. 130 prot., datë 26.1.2021, e cila ka pasur 30 ditë kohë nga marrja e vendimit për t'u përgjigjur dhe dhënë me shkrim argumentet e saj.

- Me depozitimin e deklaratës së shoqërisë "Lajthiza Invest", që ka marrë përsipër të mbështesë zbatimin e projektit dhe ndërtimin e HEC, duke u shoqëruar kjo dhe me pasqyrat financiare të kësaj shoqërie, nga të cilat konstatohet se kjo shoqëri ka aktivitet financiar pozitiv dhe aftësitë financiare për të mbështetur sa deklaruar, rezulton se shoqëria SANG 1 sh.p.k., ka përmbushur kushtin e vendimit të pikës 2.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 26.6.2019, "Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Sang 1' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Thirrë' me kapacitet të instaluar 1.820 MW"'.

- Në lidhje me shitjen e 79% e kuotave, pa marrë autorizimin e ERE-s, siç përcaktohet në nenin 6.2, të "Licencës së prodhimit të energjisë elektrike", si dhe të pikës 5.2, të "Licencës së tregtimit të energjisë elektrike", shoqëria ka deklaruar se nuk ka kuptuar drejt detyrimin e saj për të marrë autorizimin e ERE-s për këtë procedurë dhe është mjaftuar me depozitimin e akteve përkatëse në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), duke shprehur angazhimin e saj për të mos anashkaluar kompetencat e ERE-s, në lidhje me miratimin e ndryshimit të pronësisë mbi kuotat e të licencuarit.

Shoqëria "Sang 1" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për shitjen e 79% të kuotave të shoqërisë dhe ka depozituar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë këtë autorizim nga ERE.

- Shoqëria "Sang 1" sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa u përket pagesave rregullatore.

- Në nenin 9, germa "a", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se me marrjen e informacionit të detajuar, me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.

- Shoqëria "Sang 1" sh.p.k. ka depozituar në afat dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse në lidhje me objektin për të cilin Bordi i ERE-s nisi procedurat për heqjen e licencave të kësaj shoqërie, përkatësisht asaj të prodhimit të energjisë elektrike dhe të tregtimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 113, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti administrativ nga vetë organi që ka nxjerrë aktin, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën e nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 8, datë 20.1.2021, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Sang 1' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, të ndryshuar".

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 8, datë 20.1.2021, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Sang 1' sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, të ndryshuar".

3. Të përfundojë procedurën e nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 20.1.2021, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Sang 1' sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.6.2019".

4. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9, datë 20.1.2021, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Sang 1' sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.6.2019".

5. Shfuqizimin e pikës 2.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 26.6.2019, "Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 31.5.2019, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Sang 1' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Thirrë' me kapacitet të instaluar 1.820 mw"'.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 66, datë 4.3.2021

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT, NGA ANA E ERE-s, PËR SHITJEN E 79% TË KUOTAVE TË SHOQËRISË "SANG 1" SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të pikës 6.2, të "Licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"; të pikës 5.2, të "Licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 33/1 prot., datë 1.3.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 8, datë 20.1.2021 dhe me vendimin nr. 9, datë 20.2.2021, ka vendosur të fillojë procedurën përkatësisht për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Sang 1" sh.p.k., me vendimin e Bordit nr. 83, datë 31.5.2019, të ndryshuar, si dhe për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Sang 1" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.6.2019.

- Vendimet e mësipërme u morën, ndër të tjera, për shkak se rezultoi se shoqëria "Sang 1" sh.p.k. ka shitur 79% të kuotave, pa marrë autorizimin e ERE-s, siç përcaktohet në nenin 6.2, të "Licencës së prodhimit të energjisë elektrike", si dhe të pikës 5.2, të "Licencës së tregtimit të energjisë elektrike".

- Për vendimin e Bordit nr. 8/2021 dhe nr. 9/2021, ERE ka njoftuar shoqërinë nëpërmjet shkresës nr. 130 prot., datë 26.1.2021, e cila ka pasur 30 ditë kohë nga marrja e vendimit për t'u përgjigjur dhe dhënë me shkrim argumentet e saj.

- Në lidhje me shitjen e 79% të kuotave, pa marrë autorizimin e ERE-s, siç përcaktohet në nenin 6.2, të "Licencës së prodhimit të energjisë elektrike", si dhe të pikës 5.2, të "Licencës së tregtimit të energjisë elektrike", shoqëria ka deklaruar se nuk ka kuptuar drejt detyrimin e saj për të marrë autorizimin e ERE-s përpara ndërrimit të ortakëve kryesore të shoqërisë, për këtë procedurë, dhe është mjaftuar me depozitimin e akteve përkatëse në QKB, duke shprehur angazhimin e saj për të mos anashkaluar kompetencat e ERE-s, në lidhje me miratimin e ndryshimit të pronësisë mbi kuotat e të licencuarit.

- Shoqëria "Sang 1" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s, për shitjen e 79% të kuotave të shoqërisë dhe ka depozituar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë këtë autorizim nga ERE.

- Shoqëria "Sang 1" sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa u përket pagesave rregullatore.

- Shoqëria angazhohet gjithashtu se do të zbatojë me korrektësi, në vijim, detyrimet që rrjedhin nga licencat përkatëse, për të njoftuar ERE-n brenda afatit, për çdo ndryshim të adresës, administratorit apo drejtuesve të saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për shitjen e 79% të kuotave të shoqërisë "Sang 1" sh.p.k.

2. Dhënia e autorizimit nga ana e ERE-s, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk e zhvesh shoqërinë

"Sang 1" sh.p.k. nga detyrimi për të marrë miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), nëse kjo kërkohet nga ministria.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 49
Datë: 2021/03/29 19:40:35
d833ecf9-afe2-496c-9aa5-8516e4cb8213

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë